

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “Clean Seas Aqua Feed” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 04.05.2023, unë i poshtëshënuari Jacobus Johannes Mulder, i datëlindjes 11.07.1966, lindur ne Afriken e Jugut,banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte Afrikano Jugore me numër personal M00268111, me numer rezidence Shqipetare nr 268025, me cilësinë e ortakut themelues ,deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Clean Seas Aqua Feed” shpk**,

Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin**“Clean Seas Aqua Feed” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria **“Clean Seas Aqua Feed” shpk** e ka seline në adresë: “Rruga Thomai Koxhai.Nr pasurie 342/66+2-31, Zona kadastrale 3866 Vol. 35 ,Faqe 98 Yzbrerisht Tirane” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimitarise

Objekti i ushtrimit të veprimitarise per shoqërine **“Clean Seas Aqua Feed” shpk** është: “Prodhim,shitje,import dhe eksport te ushqimeve per peshqit dhe kafshet e tjera ujore”

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6 Kapitali themeltar



Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cilat zotërohet si më poshtë: Jacobus Johannes Mulder, i datëlindjes 11.07.1966, lindur ne Afriken e Jugut,banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte Afrikano Jugore me numër personal M00268111 dhe me numer rezidence Shqipetare nr 268025,zoteron 1(nje) kuote ose 100 % të kuotave të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë **"Clean Seas Aqua Feed" shpk** është: Jacobus Johannes Mulder, i datëlindjes 11.07.1966, lindur ne Afriken e Jugut,banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte Afrikano Jugore me numër personal M00268111 dhe me numer rezidence Shqipetare 268025.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë qe eshte data 04.05.2023.Afati i emërimit te administratorit eshte deri me 04.05.2028.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **"Clean Seas Aqua Feed" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKEU THEMELUES
Jacobus Johannes Mulder
Jacobus Johannes Mulder



Tiranë, më datë 04.05.2023

